



**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “Shkenca Shoqerore, Shkenca Ekonomike ”
niveli minimal i diplomës “Bachelor ”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”i ndryshuar , si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave , “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të ndryshuar, Bashkia Delvinë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

☐ 1 (një) Specialiste protokoll– kategoria e pages IV 3;

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL
NE KATEGORINE EKZEKUTIVE) APLIKOHET NE TE NJEJTEN KOHE**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
LËVIZJE PARALELE:**

16 Korrik 2026

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL:**

21 Korrik 2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- A.1 Pranon të gjithë koorespondencën dhe dokumentacionin që hyn në Bashkinë Delvinë.
- A.2 Evidenton dokumentacionin e marrë duke parë me kujdes se sa përmbushen standartet për t'a trajtuar si shkresë zyrtare;
- A.3 Protokollon të gjithë koorespondencën hyrëse dhe dalëse në rregjistrin e protokollit dhe e përgatit atë për ta cikluar tek Kryetari i Bashkisë.
- A.4 Shpërndan koorespondencën tek drejtorët , Sektorët sipas siglimit të Kryetarit të Bashkisë duke i rregjistruar dhe në librin e shpërndarjes.
- A.5 Kryen detyra të tjera që mund t'i kërkohen.
- A.6 Bën dorëzimin e dokumentacionit në arkiv sipas ligjit për Arkivat çdo fund vitë.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon IV;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Te zoteroje diplome te nivelit “Bachelor “ ne Shkencat Shoqërore .

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Delvine , dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i plotësuar;
- b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar.Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ;
- c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) në qoftëse ka;
- d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f-Vetedeklarimin e gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.07.2026.

Bashkia Delvine
Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Lagjia "Sinan Ballaci "
Rruga "Nazif Haderi "

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 19-07-2026, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Delvinë , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 "Për vetqeverisjes vendore".
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar .
- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".
- Njohuri mbi "Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", i ndryshuar,
- Njohuri mbi Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", i ndryshuar,
- Njohuri mbi Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen për pervojën ,trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën , si dhe çertifikimet pozitive .Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pike.

Kandidatet gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me :

- a- Njohurite , aftësitë , kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës ;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën .

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 60 pike.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë www.bashkiadelvine.gov.al

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljene fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, informacion që do ta merni në faqen zyrtare “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Delvine duke filluar nga data 19.07.2026.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë :

- a) Te jete shtetas shqiptare;
- b) Te kete zotësi per te vepruar ;
- c) Te zoteroje gjuhen shqipe , te shkruar dhe te folur ;
- d) Te jete ne kushte shendetsore qe lejojne te kyeje detyren perkatese;
- e) Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per te kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij te mos jete mare masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil , qe nuk eshte shuar sipas ligjit 152/2013 “Per nepunesin civil “ i ndryshuar .

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

- a) Te zoteroje diplome te nivelit “ **Bachelor** “ ne Shkencat Shoqerore .

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin:

b-Fotokopje të diplomës dhe liste notash e noterizuar.Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit ;
c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.
Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Delvine .
Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 21-07-2026 në adresën

**Bashkia Delvine
Lagjia "Sinan Ballaci "
Rruga "Nazif Haderi"**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.08.2026**, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 "Për vetqeverisjes vendore".
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar .
- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" i ndryshuar.
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare".
- Njohuri mbi "Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", i ndryshuar,
- Njohuri mbi Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", i ndryshuar,
- Njohuri mbi Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim;
- b- Intervisten e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmerinë e tyre për karrierën , deri në 25 pike.
- c- Jetëshkrimin , që konstiton në vlerësimin e arsimit të parësorë dhe të trajnimeve , të lidhura me fushën, deri në 15 pike.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine www.bashkiadelvine.gov.al si dhe në stendin e Bashkisë Delvine . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine www.bashkiadelvine.gov.al si dhe në stendin e Bashkisë Delvine :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” duke filluar nga data **03.08.2026**.

NJOFTIM MBI PROCEDURËN PËR LËVIZJEN PARALELE

NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

-1 (një) Specialiste protokolli– kategoria e pages IV 3;

Në zbatim të nenit 22 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të pikës 1, të Kreut II, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, “ Për pranimin lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” Bashkia Delvinë , në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele , për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për pozicionin:

-1 (një) Specialiste protokolli– kategoria e pages IV 3;

Nuk ka kandidatë të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurimit.

Në këto kushte plotësimi i këtij vendi të lirë pune do të vazhdojë me procedurën e pranimin në shërbimin civil.

Njoftimi i aplikantëve që plotësojnë kriteret për këtë procedurë do të bëhet në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në stendën e Bashkisë Delvinë dhe faqen zyrtare www.bashkiadelvine.gov.al duke filluar nga data **24.05.2026**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr _____ Prot

Delvinë , më ____/____/2026

Lënda : Dërgohet njoftim për publikim

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

T I R A N Ë

Përshëndetje dhe punë të mbarë!

Bashkalidhur shkresës po ju dërgojmë për publikim në portalin tuaj , njoftim për pozicionin “**Specialistë Protokolli**” në Bashkinë Delvinë .

Nga ana e jonë është dërguar dhe në rrugë elektronike në adresën tuaj “vendetelirapune@shkp.gov.al”.
Për çdo paqartësi na komunikoni ne adresën bashkia.delvine@hotmail.com , ose numër kontakti 0688058283.

Ju faleminderit për mirëkuptimin !

KRYETARI I BASHKISË

Besmir Veli

NJOFTIM MBI PROCEDURËN PËR PRANIMIN NGA JASHTË

NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

-1 (një) Specialiste protokolli– kategoria e pages IV 3;

Në zbatim të nenit 22 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të pikës 1, të Kreut II, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, “ Për pranimin lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” Bashkia Delvinë , në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele , për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për pozicionin:

-1 (një) Specialiste protokolli– kategoria e pages IV 3;

Nuk ka kandidatë të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimin.

Në këto kushte plotësimi i këtij vendi të lirë pune mbyllet pa aplikantë.

Bashkia Delvinë